



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK-KK-“Prishtinë OE ankues “Aome” Sh.p.k	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Flora Doda – Ekspert profesional i prokurimit 		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 345/19 të parashtruar nga OE “Aome” Sh.p.k		
Datë	12.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: 28.06.2019 me nr. 345/19 të parashtruar nga OE “Aome” Sh.p.k. -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AK-KK-“Prishtinë AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – AK-KK-“Prishtinë
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues- “Aome” Sh.p.k

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Aome” Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		03.07.2019	12.07.2019
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>		<i>data e autorizimit të ekspertit.</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 27.06.2019 “Aome” Sh.p.k -Prishtine ka parashtruar ankesë në OSHP , kundër njoftimit për anulim të aktivitetit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1,, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) AK-KK-“Prishtinë

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “Aome” Sh.p.k -Prishtine

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Aome” Sh.p.k -Prishtine janë:

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit ,dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Anulim

Pas ekzaminimit,krahasimit dhe vlerësimit të dokumentave të cilat e përbëjnë dojsjën e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me me dru”** me numër të e-prokurimit :616-19-2765-1-2-1 dhe Nr. I brendshëm :615-19-079-121-221 Ne në cilsinë e Operatorit Ekonomik të interesuar konsiderojmë se shpallja e Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues i publikuar në ueb faqen e platformës elektronike të KRPP-së me datë 13/06/2019 nga Autroiteti Kontraktues është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha aktet nënligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës.Në këtë mënyrë e ka dëmtuar rëndë interesin material-financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga AK të cilat janë konstatuar nga “AOME SH.P.K” ;

Ndërmarrja Tregtare shërbyese :TINI”Gjeravica Kolovicë 10000 Priostinë

Eshtë shkelur neni 1 i ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L042 (qëllimi,shfrytëzimi më efikas,më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike).i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05-L92 Eshtë shkelur neni 7i Ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L-042(Barazia në trajtim /jo Diskriminimi)i ndryshuar dhe i plotësuar ne ligjin NR.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

Eshtë shkelur neni 39 i RRUOPP-së (Sqarimi i Tenderëve).

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Aome” Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine

Eshtë shkelur neni 59 i LPP-së(Ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

Eshtë shkelur neni 41 i RRUOPP-së((Ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

Eshtë shkelur neni 62i Ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L-042(Përfundimi i aktivitetit të Prokurimit)i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 04/L-237, Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05-L92

Eshtë shkelur neni 44 i RRUOPP-së(Ndërprerja e procedurave të prokurimit).

Eshtë shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L-042(dokumentacioni dhe Informacioni shtesë)i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 04/L-237 ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05-L92

****Sipas Nenit 118 të LPP,OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar OSHPJ-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rast ku OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesën kanë qenë e rrejshme ose mashtroese.**

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Përshkurani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për fakte dhe argumente të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përshkurani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për fakte dhe argumente të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës suaj për rishqyrtim.

- Eështë sheklur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr 04/L-237 ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05-L92

1.“Të gjitha autroitetet kontraktuese,janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.

- Eështë sheklur neni 39 i RRUOPP-së(Sqarimi i Tenderëve).

Me datë13/06/2019 përmes Letër standarde për tenderuesin e eliminuar në njoftoni se jemi eliminuar me dia arsyetime të paqëndrueshme.Në arsyetim shkruani se “keni dhënë çmimin më të larë se sa çmimet mesatare të dhëna për disa artikuj dhe shërbime reprezentuese, prill2019 ku në kodin 418-dru zjarri,çmimi referent është 35.27, ndërsa ofertat e pranuar kanë çmime dukshëm më të larta”

Pas dorëzimit,përkatësisht dërgimit përmes postës elektronike të Kërkesës për Rishqyrtim më datë 01/04/2019 ju na ktheni një përgjigje menjëherë fare pa e trajtuar gjoja se Kërkesa për Rishqyrtim është dërguar pas kalimit të afatit për dorëzim dhe shkrueni në njoftim:

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1.Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1 Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit,e cila nuk mund të rregullohet apo të parandoalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit,duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitet të prokurimit.

2.Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbëjnë atë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;apo

2.2 para hapjës së tenderëve,ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe /ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjës së tenderëve.

Neni 44 i RRUOPP Ndërprerja e procedurave të prokurimit

44.1 Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit,AK menjëherë do të përgadisë dhe do të publikoj Formularin B58 :Njoftimin e Autoritetit Kontraktues”ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Aome” Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine

tillë.

44.2 Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgaditë Njoftimin për Anulimin të aktivitetit të prokurimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik.

44.3 Dorëzimi i njoftimit të anulimit të tillë në KRPP dhe publikimin e njoftimit të tillë nuk është i nevojshëm për kontratat me vlerë minimale.

44.4 Njoftimi për anulim për kontratat me vlerë të vogël dhe të mesme do të përgaditet në gjuhën shqipe, serbe, ndërsa për kontratat me vlerë të madhe në gjuhën shqipe, serbe, angleze

44.5 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme

- (i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (ii) asnjë prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- (iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE – është më pak se 3;
- (iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar ose konkurruese me negociata, është më pak se 3;
- (vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (vii) asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- (viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- (ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- (x) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformën elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit nga KRPP; ose
- (xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.6 Procedura e Prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

- (i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

44.7 Procedura e Prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme:

- (i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve;
- (ii) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformën elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i papranshëm sipas verifikimit nga KRPP;
- (iii) është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP;
- (iv) nëse është paraqitur pamundësi e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasojë e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe dokument të KRPP-së dhe AK.

44.8 Në rast të anulimit bazuar në rrethana dhe arsye të deklaruara në këtë nen, autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj tenderuesve, pjesëmarrësve ose kandidatëve për anulim të një procedure të prokurimit, subjekt i dispozitave në Nenit 405, paragraf 2.9 të LPP në lidhje me kompensimin e ankesës.

44.9 Në qoftë se një procedurë e prokurimit është anuluar dhe AK ende dëshiron të vazhdojë aktivitetin e prokurimit përkatës, AK do të fillojë një procedurë të re të prokurimit pa ndryshuar numrin e prokurimit, por duke identifikuar atë me “Ri-tender”.

Në asnjërin nga paragrafet e nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L042 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit) i ndryshuar dhe i plotësuar, e ligjin Nr 04/L-237 ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05-L92 dhe të nenit 44 të RRUORP

(Ndërprerja e procedurave të prokurimit) nuk parashihet ajo që ju e keni shkruar në arsyetimin e dhënë në Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar dhe në vendimin e juaj për anulim të këtij aktiviteti të

prokurimit.

Përgjegjën e autoritetit kontraktues, përkatësisht nga zyra e prokurimit e kemi pranuar që ka të bëjë me Kërkesën tonë për Rishqyrtim të dërguar më datë 14/06/2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru”, me numër të prokurimit:Për Aktivitetin e Prokurimit: 616-19-2765-1-2-1 dhe Nr. i mbrendshëm:615-19-079-121

Pëgjigja juaj nuk është e mbështetur në asnjë nen të –Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 04/L-237 ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05-L92, dhe në RRUOP

Pra arsyetimi i juaj është i paqëndrueshëm dhe pa argumentuar edhe pse ju thirrreni në Agjencionin e Statistikave të Kosovës çmimetë cilat i paraqet apo deklaron Agjencioni i Statistikave të Kosovës janë çmime në të cilat nuk është llogaritur dhe kalkuluar me TVSH-ja. Nëse çmimet të cilin ju e keni shënuar në arsyetim tuaj i shtohet 18% sa është norma e TVSH-së $35.27 \times 18\%$ vetëm TVSH-ja është 6.35 dhe $35.27 + 27 + 6.35 = 41.62$ euro dhe kur ti shtohën shpenzimet tjera si ngarkimi, zhgarkimi palimi dhe sharrimi i tyre e tje kalojnë çmimin të cilin ne e kemi vënë në ofertën tonë e që është një çmimi mjaft i arsyeshëm.

Si duket autoriteti kontraktues-zyrës së prokurimit nuk iu ka “shkrepur” oferta e opertaorit ekonomik të preferuar që të jetë çmim më të ulët dhe çka të bëjmë të anulojmë aktivitetin e prokurimit ndoshta herën tjetër “shkrepë” Dihet se edhe anulimi i aktivitetit të prokurimit duhet të mbështetet në LPP dhe në akte nënligjore.

Po e theksoj edhe këtë se autoriteti juaj kontraktues kontratën e vitit të kaluar e kla pasur të nënshkruar dhe realizuar me një Operator ekonomik me çmim prej 48 m kub

Andaj duke konsideruar se me vendimet e ankimuar AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave ligjore të lartëshënuara të LPP-së dhe akteve tjera nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e Operatorit Ekonomik “AOME “SH.P.K” Ndërmarrja Tregëtare Shërbyese “TINI” Gjeravica Kolovië 10000 Prishtinë kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit OSHP-ja ,përkatësisht Paneli Shqyrtues që në një seancë kryesore të hapur,ku do të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i jonë i autorizuar ,pas trajtimit të lëndës dhe shkeljeve të konstatuara të këthei landën ne ri-vlerësim pas shqyrtuesit dhe marrjes në konsideratë duke iu dhënë peshë të gjitha fakteve përkatësisht parregullsive të paraqitura në ankesë-dhe pas veprimeve korrigjuese,i propozojmë të merr këtë.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	02.05.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Vlerë e Mesme 53,000.00€
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më te ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	23.05.2019

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Aome” Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine

Data e hapjes së ofertave.....	23.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	12.06.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm.....	13.06.2019
Data e njoftimit për dhënien e kontratës:.....	13.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	14.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	17.06.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat e specifikuara në Nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP),ligji nr 04 L-42.

LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1.Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dokumentet të cilat do të kërkohen si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranushmërisë janë me se vijon 1. Një vertetim nga administrate tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dates publikimit të Njoftimit të Kontratës]-kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. 2. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administratën të dhunshëm gjygjësore të lëshuar nga Gjykata kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.Dështimi I Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në pikën ,2 dhe 3 I jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj,dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me rradhë

III.2.2. Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Certifikata e biznesit-(kopje).

III.2.4)Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional :

1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Aome" Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru " me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine

furnizimie të njejta, në vlerë minimale prej 50,000 Euro ,në 36 muajt e fundit(duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Një listë të kontratave të realizuara,duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjës së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës,shumën e kontratës,datën e përfundimit dhe përfituesin,si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	çmimi	Vërejtje
1.	GRUPI I OPERATOREVE EKONOMIK“AOME”SH.P.K.; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese”TINI”Gjeravica,1000 0 KOLOVICE	KOLOVICE	484000.00€	JO
2.	Milaim Bejta B.I z.indrustriale prishtinë,10000 prishtinë	Prishtinë	52800,00€	JO
3.	N.T.P “ALB-MISA”L.re Sofali rr.zylfie gashi 10000 Prishtinë	Prishtinë	50160,00€	JO
4.	N.T.P. “AGONITI”sheshi i arberit,10000 Prishtinë	Prishtinë	48730,00€	JO
5.	GRUPI I OPERATOREVE EKONOMIK:NTP “Rudina”; “NTP Ahu” Haxhi Zeka121,Prishtinë,10000 Prishtinë	Prishtinë	52250,00€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- | | |
|-------------------|-------------------------|
| 1.Verona Sekiraqa | - Kryetare e Komisionit |
| 2.Arber Gashi | - Anetar |
| 3.Driton Krasniqi | - Anetar |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Aome” Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru “ me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues pas vlerësimit të gjitha ofertave konstaton se të gjitha ofertat kanë çmime më të larta sesa çmimet mesatare të dhëna për disa artikuj dhe shërbime reprezentuese prill 2019 ku çmimi referent është 35.27, ndërsa ofertat e pranuar kanë çmim dukshëm më të lartë. Si vijon komisioni vlerësues i konsideron të gjitha ofertat e papërgjegjshme dhe rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

**EMRI I OPERATORËVE
EKONOMIK QË KANË DORËZUAR
TENDER TE PËRGJEGJSHËM**

VENDI

Çmimi

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues nga "Aome" Sh.p.k -Prishtine

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK Kuvendi Komunal i Prishtinës ka bërë shkelje të nenit 1,7,39,59,41,62,44 dhe 727, ekspertit shqyrtues konstaton se këto pretendime janë të bazuara për arsye se AK Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka eliminuar Operatorin ekonomik me arsyetimin se çmimi i ofruar nuk përputhet me çmimin e dhënë në indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit Prill 2019. AK duke u bazuar në këtë indeks ka bërë shkelje për arsye se në këtë indeks "mbledhen" të dhënat e tregut dhe nxirret mesatarja e çmimit të tregut për një periudhë kohore. Gjithashtu nëse AK bazohet në këtë indeks atëherë vlera e parashikuar e kontratës nga AK nuk do duhej të ishte 53,000.00 €. Operatori ekonomik ankues i plotëson të gjitha kërkesat e AK dhe çmimi i ofruar nuk e tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës nga AK.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues nga "Aome" Sh.p.k -Prishtine të aprovohet si e pa bazuar (për arsyen që u çek tek përgjigja në pretendimin nr.1) dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga "Aome" Sh.p.k -Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru " me nr. të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine